



Pranimi / Dërguar Prenje/Protokoll Receipt/Deliverly	31. 12. 2021	1	viti god year
Organ / Objekti Organ / Jednica Org / Unit	In Prok In Prok Prof No	Shtetit o Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
\$KPM\$HCK	6483/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.970/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.970/2021 të datës 30.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Brigada A. Krasniqi", Nr.5, Pejë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.970/2021 e datës 30.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoll 7/2021 i datës 22.11.2021 i Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 30.11.2021, në formë elektronike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokoll 7/2021 të datës 22.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimin ankimor se i njëjti është i paqëndrueshëm dhe i papranishëm për faktin se ankuesi ka prezantuar dokumentacionin relevant të kërkuar sipas konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje KPM\$HCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me

datë 22.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa më datë 28.12.2021 KPMShck-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka administruar vetëm provat që janë relevante dhe që kanë të bëjnë me dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe atë: Ankesën e datës 30.11.2021 me numër A.nr.970/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 5709/2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.12.2021; E-mail nga S.A. për ankesa.kpmshck i datës 30.11.2021; E-mail nga S.A. për ankesa.kpmshck i datës 30.11.2021; Letër Rekomandim i vitit 2021; Vërtetim i datës 15.10.2021; Shkresë e datës 18.10.2021; Diplomë me nr.519/15 e datës 03.03.2015; Diplomë me nr.1288 e datës 17.05.2019; Certifikatë e datës 16.06.2021; Certifikatë e muajit Mars 2004; Certifikatë e datës 17.08.2001; Certifikatë e muajit Dhjetor 2004; Certifikatë e datës 23.09.2008; Vlerësim i datës 13.12.2019; Vërtetim i datës 07.11.2003; Vërtetim i datës 10.11.2003; Certifikatë e datës 04.03.2021; Vendim me nr.7/2021 i datës 22.11.2021; E-mail nga S.A. për ankesa.kpmshck i datës 02.12.2021; E-mail nga S.A. për ankesa.kpmshck i datës 16.12.2021; Vërtetim i datës 03.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 28.12.2021; Konkurs i datës 16.09.2021; Aplikimi në SIMBNJ i S.A. i datës 18.10.2021; Vendim me nr. 28 i datës 15.11.2021; Njoftim i datës 15.11.2021; E-mail nga SH.L. për SH.H. i datës 22.12.2021; E-mail nga C.Z. për SH.L. i datës 22.12.2021; Vërtetim nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës i datës 01.12.2017; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional i datës 28.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.12.2019; Certifikatë e datës 16.05.2019; Certifikatë e datës 13.11.2003; Certifikatë e datës 17.08.2001; E-mail nga S.A. për A.K. i datës 29.10.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se organi i punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 16.09.2021 ka shpallur konkursin e hapur me Nr.Ref.RN00007618, për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, nivel i lartë drejtues 2, e në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi.

Për këtë pozitë të punës, me datë 18.10.2021, ankuesi ka dorëzuar aplikacionin me numër Kodi RAN0001124 së bashku me dëshmitë për aplikim, mirëpo Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 28/2021 të datës 15.11.2021, përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit për arsye se nuk ka përvojë profesionale dhe menaxheriale pas datës së diplomimit të studimeve themelore si dhe nuk ka ofruar Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit, ashtu siç kërkohet me konkurs.

I pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, ankuesi me datë 17.11.2021 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 22.11.2021 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 7/2021, përmes



të cilit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 17.11.2021 me arsyetimin se ankuesi nuk ka plotësuar përvojën profesionale dhe menaxheriale pas datës së diplomimit të kësaj fushe të arsimit. Kundër këtij vendimi, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i njëjti është i paqëndrueshëm dhe i papranishëm për faktin se ankuesi ka prezantuar dokumentacionin relevant të kërkuar sipas konkursit.

Organi i punësimit me rastin e shpalljes se konkursit me Nr.Ref. RN00007618, për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, ka përcaktuar kushtet e përgjithshme formale, si në vijim:

- *Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, fushat e shkollimit: administratë publike, menaxhment publik, shkenca politike ose drejtësi dhe*
- *se paku (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë në pozita udhëheqëse.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe si rrjedhojë ka gjetur se ankuesi sipas Diplomës me numër 519/15 të datës 03.03.2015 të lëshuar nga Kolegji "Universum", me datë 24.12.2014 ka përfunduar studimet themelore universitare dhe ka marrë titullin Baçelor i Arteve në Administratë Publike Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane me gjithsej 180+10 kredi/ECTS, kurse sipas Diplomës me nr.1288 të datës 17.05.2019 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ankuesi me datë 03.05.2019 ka mbaruar studimet për Master dhe ka marrë titullin Master i Shkencave Politike me gjithsej 122 kredi/ECTS. Përkitazi me përvojën e punës, Kolegji duke u bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga Zëvendësuesja e Udhëheqëses se Divizionit për Burime Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës ka konstatuar se ankuesi ka ushtruar pozitën e punës se Këshilltarit për Punësim në Zyrën Komunale të Punësimit në Deçan nga data 01.07.2000 deri me datë 30.11.2017, ndërsa nga data 01.12.2017 e tutje ushtron pozitën e punës Zyrtar për Shërbime të Punësimit në Zyrën e Punësimit në Deçan. Andaj, nisur nga fakti se fushat e arsimit sipas konkursit kanë qenë Administratë Publike e të tjera, Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës se punës profesionale pas diplomimit sepse i njëjti ka përfunduar studimet themelore nga fusha e Administratës Publike me datë 24.12.2014, e po ashtu ankuesi nuk ka përvojë pune në pozita udhëheqëse ashtu siç është përcaktuar me konkursin e datës 16.09.2021, e në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Duke marrë parasysh konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson se Divizioni i Zhvillimit të Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 7/2021 të datës 22.11.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 40 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 paragrafin 1, 2 dhe 6 të Rregullores NR.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.970/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

